



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I GJEOGRAFISË



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **Gjeografi**

**Lënda: KLIMATOGJEOGRAFIA**

<i>Pedagogu:</i>	Doc. Dr. Arben BELBA
<i>Ngarkesa:</i>	4 ETCS (15 javë: 2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	e detyrueshme
<i>Viti/semestri:</i>	I/I

**Shkurtesë:** Klimatogjeografia është pjesë e disiplinave me karakter teorik dhe aplikativ. Ajo i mundëson studentëve njohuritë bazë mbi klimën duke e vlerësuar atë si pjesë e rëndësishme e mjedisit fizik të një hapësire gjeografike. Të dhënat meteorologjike vijnë prej monitorimit të vazhdueshëm në kohë dhe hapësirë. Ato krijojnë bazën e të dhënave dhe paraprijnë njohuritë për çdo element klimatik. Zonalizimi i përhapjes gjeografike së elementëve klimatikë përcakton tiparet klimatike dhe klasifikimet klimatike. Me rëndësi janë gjithashtu njohuritë mbi ndryshimet e pritshme klimatike dhe pasojat që rrjedhin prej tyre. Potenciali klimatik dhe dukuritë ekstreme të motit janë oferta e risku natyror, si për shfrytëzimin e energjive alternative ashtu edhe për vlerësimin ekonomik të klimës. Në këtë mënyrë njohuritë klimatogjeografike janë pjesë e rëndësishme e formimit gjeografik të studentëve tanë që krahas njohurive teorike të aftësohen në alternimin e koncepteve me përdorimin praktik. Njohuritë klimatogjeografike janë të domosdoshme për mjaft degë të rëndësishme të ekonomisë dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendi.

**Temat e leksioneve:**

1. Objekti, përmbajtja, detyrat dhe rëndësia e studimit të Klimatologjisë. Historia e vrojtimeve meteorologjike në botë dhe në vendin tonë.
2. Atmosfera, shtrirja, përbërja e saj. Struktura vertikale e atmosferës. Troposfera shtresa e “motit” hapësira e vetme ku vrojtohen të gjitha dukuritë meteorologjike që kushtëzojnë formimin e një klime të caktuar mbi sipërfaqen e tokës.
3. Rrezatimi diellor, Dielli si burim rrezatimi, Intensiteti i rrezatimit, konstantja diellore, llojet e rrezatimit dhe ecuria ditore e vjetore e tij. Pajisjet monitoruese për rrezatimin diellor.
4. Temperatura e ajrit. Njohuri themelore mbi ngrohtësinë dhe temperaturën. Ngrohja e ftohja adiabatike e ajrit. Inversionet termike. Ecuria ditore, vjetore e temperaturës së ajrit dhe shpërndarja gjeografike e saj. Periudha e vegjetacionit dhe ngricat. Pajisjet monitoruese të temperaturës.
5. Avulli i ujit. Tensioni i ajrit të ngopur (saturimi). Lagështia e ajrit, absolute e relative e ajrit. Defiçiti i lagështirës dhe pika e vesës. Ecuria ditore, vjetore e lagështisë absolute e relative të ajrit dhe shpërndarja gjeografike e saj. Pajisjet monitoruese të lagështisë së ajrit.
6. Avullimi nga sipërfaqja e ujit dhe ajo tokësore. Kondensimi e sublimimi dhe shkaqet e produktet e tyre. Retë dhe klasifikimi i tyre. Vranësira dhe treguesit e saj.
7. Vranësirat e reshjet kushtet e formimit të tyre. Lloji i reshjeve e raporti midis tyre. Ecuria ditore, vjetore e reshjeve dhe shpërndarja gjeografike e saj. Pajisjet matëse për reshjet.

8. Trysnia atmosferike, njësitë matëse dhe ndryshimi i tij sipas lartësisë. Ecuria ditore, vjetore e trysnisë së ajrit dhe shpërndarja gjeografike e saj. Informacionet meteorologjike satelitore.
9. Era dhe shkaqet e formimit të saj. Elementet e erës. Potencialet aeroenergjitike si burim energjie alternative dhe një vlerësim mbi paraqitjen e saj në vendin tonë. Erërat lokale.
10. Masat ajrore dhe klasifikimi i tyre. Frontet atmosferike, tipet dhe dinamika e proceseve që ndodhin në to. Qendrat barike ciklonare e anticiklonare.
11. Qarkullimi i përgjithshëm i atmosferës. Qarkullimi ndërtropikal; i musoneve, gjerësive mesatare e të mëdha. Skema treqelizore e qarkullimit.
12. Klima, faktorët klimëformues. Dallimi midis klimës detare, kontinentale e malore. Klimat lokale, mikroklimat. Zonaliteti klimatik. Klasifikimet ndërkombëtare të klimave sipas Këpenit, Bergut, Trewartes, Alisove.
13. Ndryshimet klimatike, faktorët ndikues dhe tendencat për të ardhmen. Anët pozitive dhe negative të këtyre ndryshimeve. Politikatat globale e lokale për minimizimin e pasojave nga ndryshimet klimatike.
14. Klima e Shqipërisë dhe veçoritë sipas zonave dhe nënzonave të saj.
15. Fenomenet ekstreme të motit dhe klimës, tiparet e tyre. Vlerësimi i mundësive për mënjanimin e minimizimin e pasojave negative në jetën e njeriut dhe ekonominë e vendit, si në rastin e thatësisës, përmytjeve, zjarreve në pyje dhe ngricave e akujve.

#### **Forma e kontrollit dhe vlerësimit**

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II: në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursit ose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

#### **Literatura e detyrueshme për studentin:**

1. P. Zorba, *Klimatologjia*, © AlbPAPER, Tiranë 2009.
2. S. Jaho, *Klimatologjia*, Tekst mësimor, Tiranë 1988.

#### **Literatura plotësuese:**

1. John R. Herman, Richard A. Goldberg, *Sun, Weather and Climate*, NASA, USA 1978
2. M. Pina, *Climatologia*, Edizione © Roma, Italy, 1997.
3. Akademia e Shkencave, Klima e Shqipërisë, HIDMET, Tiranë, 1975.
4. A. Belba, *Veçoritë e erërave në fushëgropën e Korçës*, Tiranë, 1991
4. American Meteorological Society, *Glossary of Meteorology*, Second Edition © 2000, USA.
5. Robert G. Fovell, *Meteorology: An Introduction to the Wonders of the Weather*, University of California, Los Angeles, USA. 2010.